

VENDIM
Nr. 101, datë 4.7.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË
“M.T.C ENERGY” SHPK NË FAVOR TË BANKËS “RAFFEISEN BANK” SHA**

Në mbështetje të neneve 16; 20, pika “a”; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k. për lënie peng asetesh në favor të bankës “Raffelsen Bank” sh.a, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit” si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germet: “a” (ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); “b” (veprimtaria e licencuar); “d” (përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); “e” (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen); “i” (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit).

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me germën “c” (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve); “f” (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit); “g” (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar), të pikës 1, të nenit 7 do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k. për lënie peng të asetëve në favor të bankës “Raffelsen Bank” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti